



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Pranimi / Dorezimi Prilazje / Prilazje Received / History	23. 01 2024	5	vit god year
Organ / Shkronja Organ / Shkronja Org. / Short	Nr. Prot. Nr. Prot. Prot. No.	Shtesa / Prilog Appendix	Sasia / Kolicina Quantity
SKPM SHCK	436/2024		1/1



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

VM/2024
Datë: 23/01/2024

Në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, nenit 7 paragrafit 1 nën paragrafi 1.6, nenit 20 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr. 01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, nenit 6 paragrafi 1, 2, 4 dhe 5, nenit 14 paragrafi 1 të Rregullore Nr. 04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike Lidhur me Zbatimin e Rregullave të Legjislacionit për Shërbimin Civil, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në mbledhjen e dytë (II) të mbajtur më datë 22.01.2024 dhe të vazhduar më datë 23.01.2024, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti i Monitorimit të Jashtëzakonshëm në Administratën Tatimore të Kosovës.
2. Obligohet Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë dhe Komisioni i Ristrukturimit në Administratën Tatimore të Kosovës që në afat prej 45 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë zbatimin e tij së bashku me rekomandimet në raport.
3. Këshilli të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Arben MEHMETI
Kryesues i KPM SHCK-së

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorit Ekzekutiv të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Komisionit të Ristrukturimit në Administratën Tatimore të Kosovës
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës; dhe
- Arkivit të Këshillit.



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBYMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimi / Datozimi Priljepljen / Priljepljen Received / Delivered		23.01.2024		9	viti god year
Organ / Institucija Organ / Institution Org. / Inst.	Bi. Prof. In. Prof. Prof. No.	Shtetja Priljepljen Appendix	Seri Kopje Quantity		
SKPM/SHUK 436/2024			1197		



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBYMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

RAPORTI I MONITORIMIT TË JASHTËZAKONSHËM
NË
ADMINISTRATËN TATIMORE TË KOSOVËS

Prishtinë, janar 2024

PËRMBAJTJE	2
HYRJE.....	3
FUNKSIONI I MONITORIMIT.....	3
METODOLOGJIA E MONITORIMIT.....	3
RAPORTI I MONITORIMIT NË ATK.....	4 - 17

HYRJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejshëm referuar: Këshilli*) është institucion i pavarur i themeluar me aktin më të lartë juridik të Republikës së Kosovës, përkatësisht me nenin 101.2 të Kushtetutës, me mandat specifik për sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.

Këshilli ushtron funksionet dhe përgjegjësitë themelore në pajtim me:

- Kushtetutën e Republikës së Kosovës;
- Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe aktet nënligjore që burojnë nga ky ligj; dhe
- Aktgjykimin në rastin KO171/18 të datës 20 maj 2019 të Gjykatës Kushtetuese.

FUNKSIONI I MONITORIMIT

Këshilli funksionin e monitorimit të jashtëzakonshëm e ushtron mbi bazën e autorizimeve ligjore të përcaktuara me nenin 20 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.48/2018 për Monitorimin e Institucioneve të Administratës Publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit të shërbimit civil.

Përmes ushtrimit të funksionit të monitorimit, vlerësohet zbatimi i rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, me qëllim të krijimit të një administratë publike, profesionale dhe efikase, sipas standardeve me të mira evropiane.

Këshilli, në procesin e monitorimit të institucioneve të administratës publike përgatit raport me të gjetura dhe rekomandime dhe nxjerr vendim, të cilin së bashku me raport ia dërgon institucionit përkatës.

Zyrtaret përgjegjës të institucionit të administratës publike në të cilin është realizuar monitorimi janë të obliguar për zbatimin e rekomandimeve, brenda afatit të përcaktuar në vendim të Këshillit.

METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Monitorimi realizohet përmes njoftimit paraprak dhe realizimit të vizitës në institucionin përkatës të administratës publike që posedon dokumentacionin e nevojshëm, përzgjedhjes së mostrave, intervistimit të nëpunësve civil, rishikimit të dokumenteve dhe verifikimit fizik të tyre.

RAPORT I MONITORIMIT TË JASHTËZAKONSHËM NË ADMINISTRATEN TATIMORE TË KOSOVËS

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës gjatë implementimit të mandatit kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, realizon monitorim të jashtëzakonshëm në rastet kur konsideron së janë bërë shkelje të rënda të legjislacionit të shërbimit civil.

Për shkak të numrit të madh të ankesave të pranuar nga nëpunësit civil të Administratës Tatimore të Kosovës lidhur me procesin e transferimit si pasoje e ristrukturimit të brendshëm, Këshilli në mbledhjen e mbajtur me datë 16.02.2023, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së këtij procesi në kontekst edhe të pretendimeve ankimore ka nxjerr Vendim VMK/2023 dhe me numër protokolli 1851/2023 përmes të cilit është vendosur që të realizohet monitorim *ad hoc* në Administratën Tatimore të Kosovës.

Rrjedhimisht, më datë 20.02.2023 janë njoftuar zyrtaret përgjegjës të institucionit përkatës lidhur me vizitën monitoruese, ndërsa më datë 23.02.2023 është realizuar vizitën në Administratën Tatimore të Kosovës ku edhe janë siguruar prova-dokumente të nevojshme për të vlerësuar procesin e transferimit të nëpunësve civil, duke u ndërlidhur gjithnjë me ankesat e parashtruara paraprakisht në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Gjendja faktike

Këshilli në procesin e monitorimit në Administratën Tatimore të Kosovës (*në tekstin e mëtejme tutje referuar: ATK*) ka gjetur se Kryeministri i Republikës së Kosovës, me datë 23.09.2022 ka miratuar Rregulloren Nr.02/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Tatimore të Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi më datë 05.10.2022, dhe ka për qëllim përcaktimin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Tatimore të Kosovës.

Rrjedhimisht, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë (*në tekstin e mëtejme tutje referuar: DMZP*), në mbështetje të nenit 54 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenit 14 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, me datë 07.10.2022 ka nxjerr Vendimin Nr.1503 me të cilin ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për Administratën Tatimore të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar si: Komisioni i Ristrukturimit*) në përbërje nga:
përfaqësuese nga DMZP, në cilësinë e kryesuesit të Komisionit të Ristrukturimit,
dhe përfaqësues nga ATK në cilësinë e anëtareve të Komisionit të Ristrukturimit.

Roli dhe funksionet e Komisionit të Ristrukturimit

Roli dhe funksionet e Komisionit të Ristrukturimit janë të përcaktuara me dispozitat e nenit 54 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë (i aplikueshëm nga data 09.07.2020 – 25.09.2023).

Me dispozitat e nenit 54 paragrafi 3 dhe 5 të këtij ligji, përcaktohet se: 3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet një komision ristrukturimi, i cili shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozitë të lirë, në të cilën ai i plotëson kërkesat e veçanta. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia e pranimit, në bazë të propozimit të komisionit. 5. Komisioni i ristrukturimit, i parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, drejtohet nga njësia e pranimit dhe në të bëjnë pjesë përfaqësues të institucioneve të parashikuara në paragrafët 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të nenit 54 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Komisioni i Ristrukturimit sipas dispozitave ligjore përkatëse, është organi i cili i propozon DMZP-së transferimin e nëpunësve civil në pozitat e reja të rezultuara si pasojë e ristrukturimit, brenda të njëjtit institucion, ose në pamundësi, në institucione të tjera, të prekura, apo jo, nga ristrukturimi. Komisioni ka për detyrë të ekzaminojë dhe të vlerësojë të gjitha ndryshimet strukturore që kanë ndodhur në institucion/institucione dhe të bëjë listën e të gjithë nëpunësve që preken nga ristrukturimi.

Veprimet e Komisionit të Ristrukturimit

Këshilli nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se komisioni i ristrukturimit në përbërje si me lartë ka përgatitur tri raporte përfundimtare me propozime për sistemimin e nëpunësve civil të ATK-së, si në vijim:

1. Raportin me numër reference KR/ATK-08/2022 të datës 05.12.2022 lidhur me sistematizimin e nëpunësve civil në pozita të nivelit të mesëm drejtues dhe nivelin e ulët drejtues (drejtorë të departamenteve dhe udhëheqës të divizioneve);
2. Raportin me numër reference KR/ATK-09/2022 të datës 07.12.2022 lidhur me sistematizimin e nëpunësve civil në pozita të nivelit profesional; dhe
3. Raportin me numër reference KR/ATK/2022 të datës 03.11.2022 lidhur me sistematizimin e Udhëheqësit të Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Udhëheqësit të Divizionit të Burimeve Njerëzore.

Raportet e komisionit përkatës të ristrukturimit kanë pasuar me lëshimin e vendimeve për sistemim dhe rrjedhimisht aktet e emërimit për nëpunësit civil të ATK-së.

Nëpunësit civil të cilët kanë parashtruar ankesë kundër sistemimit

Ndaj vendimeve për sistemim dhe akteve të emërimit, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nëpunësit civil si në vijim:

Sistemimi i nëpunësve civil në pozita drejtuese

Këshilli, në kuadër të autorizimeve kushtetuese dhe ligjore për mbikëqyrjen e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil si dhe në kuptim të pretendimeve ankimore të parashtruara si në ankesë ka analizuar Raportin me numër reference KR/ ATK-08/2022 të datës 05.12.2022 dhe si rrjedhojë ka gjetur se Komisioni i Ristrukturimit ka propozuar transferimin e nëpunësve civil në pozita të mesme drejtuese, gjegjësisht sipas këtij raporti nëpunësi civil [] i cili ka qenë duke ushtruar pozitën e Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm për Operacione është propozuar për sistemim në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Arka Fiskale, Pensione dhe Sigurime, nëpunësi civil [] i cili ka qenë duke ushtruar pozitën e Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm për Programe dhe Procedura është propozuar të transferohet në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Transferim të Çmimeve dhe Ekonomi Digjitale, ndërsa nëpunësi civil [] cili ka qenë duke ushtruar pozitën e Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm për Mbështetje të Programeve dhe

Procedurave është propozuar të transferohet në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Shërbime të Përgjithshme.

Po ashtu, sipas Raportit me numër reference KR/ATK-08/2022 të datës 05.12.2022, nëpunësi civil është propozuar për transferim nga pozita e drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Mbledhjes së Borxheve në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Mbledhjes së Borxheve, nëpunësi civil

është propozuar për transferim nga pozita e udhëheqësit të Divizionit të Ankesave, në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit të Ankesave, nëpunësi civil

i cili ka qenë duke ushtruar pozitën e Ndihmës Drejtorit Rajonal në Prishtina 3, është propozuar për sistemim në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Shërbime Mbështetëse në Departamentin Tatimor Rajonal në Prishtina 3, nëpunësi civil

i cili ka qenë duke ushtruar pozitën e Ndihmës Drejtorit Rajonal në Prizren 1, është propozuar për sistemim në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Shërbime Mbështetëse në Departamentin Tatimor Rajonal në Prizren 1, nëpunësi civil

i cili ka qenë duke ushtruar pozitën e Ndihmës Drejtorit Rajonal në Prizren 2, është propozuar për sistemim në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Shërbime Mbështetëse në Departamentin Tatimor Rajonal në Prizren 2.

Rrjedhimisht, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publik, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, duke u bazuar në propozimin e komisionit të ristrukturimit, ka transferuar nëpunësit civil të lartcekur në pozita drejtuese, dhe atë, si në vijim:

- Me Vendimin Nr.17/2022 të datës 09.12.2022 nëpunësi civil është transferuar nga pozita e Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm për Operacione në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Arka Fiskale, Pensione dhe Sigurime dhe të njëjtit për pozitën përkatëse i është lëshuar Akti i emërimit me numër AE.Nr.17/2022 të datës 12.12.2022.
- Me Vendimin Nr.18/2022 të datës 09.12.2022 nëpunësi civil është transferuar nga pozita e Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm për Programe dhe Procedura në pozitën e punës Drejtor i Departamentit për Transferim të Çmimeve dhe Ekonomi Digjitale, dhe të njëjtit për pozitën përkatëse i është lëshuar Akti i emërimit me numër AE.Nr.18/2022 të datës 12.12.2022.
- Me Vendimin Nr.19/2022 të datës 09.12.2022 nëpunësi civil është transferuar nga pozita e Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm për Mbështetje të Programeve dhe Procedurave në pozitën e punës Drejtor i Departamentit për Shërbime të Përgjithshme, dhe të njëjtit për pozitën përkatëse i është lëshuar Akti i emërimit me numër AE.Nr.19/2022 të datës 12.12.2022.
- Me Vendimin Nr.05/2022 të datës 09.12.2022 nëpunësi civil është transferuar nga pozita e drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Mbledhjes së Borxheve në pozitën e punës drejtor i Departamentit për Menaxhimin e Mbledhjes së

Borxheve, dhe të njëjtit për pozitën përkatëse i është lëshuar Akti i emërimit me numër AE.Nr.05/2022 të datës 12.12.2022.

- Me Vendimin Nr.50/2022 të datës 12.12.2022 nëpunësi civil i cili ka qenë duke ushtruar pozitën e udhëheqësit të Divizionit të Ankesave, në pozitën e udhëheqësit të Divizionit të Ankesave, dhe të njëjtit për pozitën përkatëse i është lëshuar Akti i emërimit me numër AE.Nr.50/2022 të datës 13.12.2022.
- Me Vendimin Nr.61/2022 të datës 12.12.2022 nëpunësi civil i cili ka qenë duke ushtruar pozitën e Ndhmës Drejtorit Rajonal në Prishtina 3, është propozuar për sistemim në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Shërbime Mbështetëse në Departamentin Tatimor Rajonal në Prishtina 3, dhe të njëjtit për pozitën përkatëse i është lëshuar Akti i emërimit me numër AE.Nr.61/2022 të datës 13.12.2022.
- Me Vendimin Nr.63/2022 të datës 12.12.2022 nëpunësi civil Fehmi Veselaj i cili ka qenë duke ushtruar pozitën e Ndhmës Drejtorit Rajonal në Prizren 1, është sistemuar në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Shërbime Mbështetëse në Departamentin Tatimor Rajonal në Prizren 1, dhe të njëjtit për pozitën përkatëse i është lëshuar Akti i emërimit me numër AE.Nr.63/2022 të datës 13.12.2022.
- Me Vendimin Nr.64/2022 të datës 12.12.2022 nëpunësi civil Ramadan Kryeziu i cili ka qenë duke ushtruar pozitën e Ndhmës Drejtorit Rajonal në Prizren 2, është sistemuar në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Shërbime Mbështetëse në Departamentin Tatimor Rajonal në Prizren 2, dhe të njëjtit për pozitën përkatëse i është lëshuar Akti i emërimit me numër AE.Nr.64/2022 të datës 13.12.2022.

Këshilli nga shqyrtimi dhe analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Komisioni i Ristrukturimit propozimin për sistemimin e tre nëpunësve civil të lartcekur të cilët ushtronin pozita të zëvendës drejtorit të përgjithshëm e ka mbështetur në arsyetimin e vetëm se këta nëpunës civil kanë qenë duke mbajtur pozitën vetëm me vendim të drejtorit të përgjithshëm duke mos iu nënshtruar asnjë procedure të konkurrimit sikurse ka qenë e paraparë me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil, madje duke ju ndryshuar koeficienti i pagës prej 10 në 15 vetëm me një kërkesë formale drejtuar MAP-it në vitin 2013. Tutje sipas komisionit përkatës të ristrukturimit, e njëjta praktikë për emërimin e zëvendës drejtorëve të përgjithshëm pa iu nënshtruar rregullave të shërbimit civil është përsëritur edhe në vitin 2016 me ç'rast bartësit e atyre pozitive në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil në atë kohë, vetëm me vendim të drejtorit të përgjithshëm janë pajisur me akte emërimi pa afat dhe për pasojë ato akt emërimi kanë qenë të pa bazuara dhe të pa mbështetura në ligj.

Këshilli vlerëson se arsyetimi i komisionit përkatës të ristrukturimit i dhënë si në Raportin KR/ ATK-08/2022 të datës 05.12.2022, mbi bazën e të cilit arsyetim, nëpunësit civil:

është propozuar për transferim në pozita të mesme drejtuese nuk përkon me autorizimet e dhëna sipas nenit 54 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ngase institucioni përkatës, gjegjësisht ATK-ja, sipas

shkresave të lëndës ka qenë në proces të ristrukturimit dhe se ky komision sipas dispozitave ligjore në fuqi, në këtë proces, ka për detyrë të ekzaminojë dhe të vlerësojë të gjitha ndryshimet strukturore që kanë ndodhur në institucion dhe të bëjë listën e të gjithë nëpunësve që preken nga ristrukturimi dhe pastaj t'i propozoj DMZP-së transferimin e nëpunësve civil në pozitat e reja të rezultuara si pasojë e ristrukturimit, brenda të njëjtit institucion, ose në pamundësi, në institucione të tjera, të prekura, apo jo, nga ristrukturimi, por jo të lëshohet në vlerësimin e ligjshmërisë së akteve të emërimit të nëpunësve civil, siç ka vepruar në rrethanat e rastit konkret.

Për me tepër nga administrimi i shkresave të lëndës është vërejtur se i njëjti komision ketë standard (*vlerësimin e ligjshmërisë së akteve të emërimit*) e ka ndjekur vetëm në raport me nëpunësit civil të lartcekur, por jo edhe me nëpunësit tjerë civil. Si rrjedhojë, rezulton se komisioni përkatës i ristrukturimit, në rrethanat e rastit konkret nuk ka marr për bazë Vendimin A.nr.461/2021 të datës 23.06.2021 si dhe Vendimin A.nr.484/2021 të datës 18.6.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me të cilat vendime Këshilli kishte aprovuar ankesën e nëpunësit civil dhe nëpunësit civil dhe të njëjtit janë kthyer në pozitat përkatëse si zëvendës drejtorë të përgjithshëm me ç'rast edhe janë lëshuar aktet e reja të emërimit nga udhëheqësi me i lart administrativ i ATK-së.

Po ashtu, nëpunësi civil sipas shkresave të lëndës ka qenë i emëruar në pozitën e zëvendës drejtorit të përgjithshëm, dhe se i njëjti sipas Vendimit me numër të protokollit 180 të datës 09.07.2021 në momentin e ristrukturimit ishte duke ushtruar detyrën e drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Mbledhjes së Borxheve, vendim ky ndaj të cilit ankuesi kishte iniciuar konflikt administrativ në gjykatën kompetente, ndërsa, sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore A.nr.2571/2021 të datës 29.05.2023, Këshilli me Vendimin Anr.728/2021, të datës 29.06.2023 ka aprovuar aneksen e ankuesit dhe ka anuluar Vendimi me numër të protokollit 180 të datës 09.07.2021 të ATK-së.

Andaj, për sa me sipër Këshilli vlerëson se komisioni përkatës i ristrukturimit në raport me nëpunësit e lartcekur ka dështuar të konstatojë drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike ashtu sikurse edhe ka zbatuar gabimisht ligjin material, duke tejkalluar kështu autorizimet e dhëna ligjore sipas dispozitave të nenit 54 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ngase i njëjti është lëshuar në vlerësimin e ligjshmërisë së akteve të emërimit të nëpunësve civil dhe atë në mënyrë parciale vetëm për pozitat e zëvendës drejtorëve të përgjithshëm, përkundër faktit se për disa prej tyre ishin në dijeni se është vendosur me vendime të formës së prerë në procedurë administrative nga organet kompetente sikurse është Këshilli, dhe se në kuptim të nenit 21 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendimet e Këshillit janë vendime administrative të formës së prerë dhe zbatohen nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit.

Në ndërlidhje me pozitat e zëvendës drejtorëve të përgjithshëm, Këshilli analizoi legjislacionin e shërbimit civil, gjegjësisht:

Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (i aplikueshëm nga data 10.07.2010 deri me datë 09.07.2020), me theks të veçantë nenin 23 ku përcaktohej se: "1. Personeli i punësuar në Shërbimin Civil ndahet në katër (4) kategori funksionale: 1.1. nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues; 1.2. nëpunës civilë të nivelit drejtues; 1.3. nëpunës civilë të nivelit profesional; 1.4. nëpunës civilë të nivelit tekniko – administrativ", ndërlidhur me këtë, nenin 4 paragrafi 1 të Rregullores Nr.05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, përcaktohej se: "Vendet e punës në institucionet e nivelit qendror dhe lokal në Shërbimin Civil ndahen në katër kategori funksionale: 1.1. Niveli i Lartë Drejtues, është pozitë përgjegjëse për menaxhimin e përgjithshëm administrativ të institucionit të administratës publike në shërbimin civil. 1.2. Niveli Drejtues, është pozitë përgjegjëse për menaxhimin dhe koordinimin e punës në fushë të caktuar të veprimtarisë së institucionit të administratës publike në shërbimin civil...".

Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik (i aplikueshëm nga data 10.07.2020 deri me 26.09.2023), përkatësisht dispozitat e nenit 33 paragrafi 2 ku përcaktohet se: "Pozitat në Shërbimin Civil ndahen në këto kategori: 2.1. Kategoria e lartë drejtuese, që përfshin këto pozita: sekretar i përgjithshëm, drejtor ekzekutiv dhe zëvendës drejtor i një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme; 2.2. Kategoria e mesme drejtuese, që përfshin këto pozita: drejtor i departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.3. Kategoria e ulët drejtuese, që përfshin këto pozita: shefi i divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të; dhe 2.4. Kategoria profesionale, që përfshin zyrtarët profesionalë" ndërlidhur me këtë nenin 4 paragrafi 1.1, nenin 5 dhe nenit 10 të Rregullores Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: "4. Në pajtim me ligjin për zyrtarët publik, pozitat e punës në shërbimin civil dhe institucionet e administratës së shërbimit publik ndahen në këto kategori funksionale: 1.1. kategoria e lartë drejtuese; 5.1. Kategoria e lartë drejtuese është kategoria më e lartë e menaxhimit të një institucioni që ka përgjegjësinë për hartimin e politikave dhe këshillimin rreth tyre. Pozitat e kësaj kategorie janë përgjegjës për të: 1.1. përcaktuar objektivat dhe hartuar programet, standardet dhe procedurat përkatëse për zbatim; 1.2. siguruar përdorimin efikas të burimeve materiale, njerëzore dhe financiare të nevojshme për realizimin e programeve dhe arritjen e objektivave; 1.3. planifikuar dhe drejtuar veprimtarinë e përditshme administrative të institucionit; 1.4. përfaqësuar atë në takime dhe forume brenda dhe jashtë vendit. 10. Klasat përbërëse të kategorisë së Lartë Drejtuese dhe emërtesat e lejuara për secilën klasë janë: Drejtues i Lartë 3 Zëvendës drejtor Ekzekutive në një Agjenci të Pavarur, Rregullatore dhe Ekzekutive".

Ligjin Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, përkatësisht nenin 12 ku përcaktohet se: Agjencia Ekzekutive themelohet për të kryer funksionet administrative brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të një ministrie apo Zyrës së Kryeministrit, si në vijim: 1.1. zbatimin e ligjit, duke zgjidhur çështje individuale dhe duke kryer veprime administrative sipas Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative; 1.2. mbledhjen e tatimeve, taksave, detyrimeve doganore, kontributeve apo

detyrimeve të tjera dhe menaxhimin e tyre për qëllimin për të cilin janë krijuar; 1.3. mbrojtjen e sigurisë publike nëpërmjet ushtrimit të autorizimeve policore, dhënien e lejeve, licencave, autorizimeve dhe miratimeve për veprimtari ekonomike specifike dhe kryerjen e inspektimeve; 1.4. mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave dhe informacionit për Qeverinë; 1.5. ushtrimin e përbashkët të funksioneve të brendshme mbështetëse. 2. Agjencia Ekzekutive themelohet me ligj", kurse, me nenin 22 të këtij ligji është përcaktuar se: 1. Agjencia Ekzekutive drejtohet nga drejtori ekzekutiv. 2. Drejtori ekzekutiv i Agjencisë është nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese sipas ligjit për zyrtarët publikë. 3. Drejtori ekzekutiv për performancën dhe veprimtarinë e Agjencisë, i përgjigjet ministrit dhe informon Sekretarin e Përgjithshëm. 4. Në rastet e agjencive të mëdha dhe me veprimtari komplekse, në ligjin e themelimit të agjencisë mund të përcaktohet që drejtori ekzekutiv të mbështetet nga jo më shumë se (2) dy zëvendës drejtorë. Zëvendës drejtori është nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese sipas ligjit për zyrtarët publikë.

Ligji Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, përkatësisht, nenin 4 paragrafi 1 më të cilin është përcaktuar se : Drejtori i Përgjithshëm do të ndihmohet nga Zëvendës Drejtorët e Përgjithshëm, dhe /ose Drejtorët. Zëvendës Drejtorët e Përgjithshëm dhe Drejtorët do të propozohen nga një panel i formuar në përputhje me legjislacionin relevant apo rregulloret në fuqi" Mbi Shërbimin Civil të Kosovës" dhe do të udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm. Drejtori i Përgjithshëm do të marrë vendimin përfundimtar mbi emërimin e Zëvendës Drejtorëve, bazuar në rezultatet e intervistave dhe procesit të emërimit të Shërbimit Civil të Kosovës.

Rrjedhimisht, referuar kuadrit ligjor si me lartë, Administrata Tatimore e Kosovës ndonëse edhe me herët e kishte statusin e agjencisë ekzekutive, pozita e zëvendës drejtorit të përgjithshëm në këtë institucion nuk kategorizohej si pozitë e nivelit të lartë drejtues, nga rrjedh se marrëdhënia e punës në pozitën përkatëse themelohej me afat të përhershëm/karrierës. Ndërsa, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik (me datë 10.07.2020) edhe pozita e zëvendës drejtorit të një agjencie ekzekutive, duke përfshi këtu edhe ATK-në kualifikohej si pozitë e kategorisë së lartë drejtuese dhe për pasojë marrëdhënia e punës për pozitën përkatëse themelohej me mandat të caktuar, katër (4) vjeçar.

Andaj, duke qenë se me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, pozita e zëvendës drejtorit të një agjencie ekzekutive kualifikohet si pozitë e nivelit të lartë drejtues, me afat të caktuar, katër (4) vjeçar, dhe se procedura e rekrutimit për këto pozita dallon nga procedura e rekrutimit të nëpunësve të karrierës, Këshilli vlerëson se ministria përgjegjëse për administratë publike, respektivisht njësia përgjegjëse në kuptim të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka qenë e obliguar që paraprakisht të rregulloj statusin e pozitave përkatëse, në kuptim të nenit 83 të Ligjit për Zyrtarët Publikë, duke përfshi këtu edhe pozitën e zëvendës drejtorëve të përgjithshëm, dhe pastaj të njëjtit t'i nënshtrohen procesit të sistemimit sipas dispozitave të këtij ligji.

Këshilli, nga analizimi i Raportit me numër reference KR/ATK-08/2022 të datës 05.12.2022, po ashtu ka gjetur se nëpunësi civil: dhe

të cilët mbanin pozitën e zëvendës drejtorit rajonal, janë transferuar pa ndonjë arsytim eventual nga komisioni përkatës i ristrukturimit, dhe për pasojë ka qenë e pamundur që të kuptohet se si ka ardhur deri të propozimi për transferimin e tyre në pozitë përkatëse të punës, rrjedhimisht komisioni i ristrukturimit nuk ka dhënë asnjë shpjegim të fakteve relevante dhe bazën ligjore lidhur me transferimin e nëpunësve civil si me lartë.

Andaj, transferimi i nëpunësve civil. dhe

pa një arsytim paraprak të dhënë në mënyrë të shkruar nga komisioni i ristrukturimit, bje ndesh me dispozitat e nenit 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase është fakt i pamohueshëm se në rrethanat e rastit konkret ka ndryshuar marrëdhënia e punës e nëpunësve civil, përkatësisht është shuar pozita e zëvendës drejtorit rajonal dhe se të njëjtit në mungesë të një arsytimi me shkrim nuk kanë pasur mundësinë që ta kuptojnë propozimin dhe rrjedhimisht vendimin për transferim e tyre në pozitë përkatëse dhe jo në ndonjë pozitë tjetër, për çka me të drejtë edhe kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Bazuar në rrethanat si me lartë, Raporti me numër reference KR/ATK-08/2022 i datës 05.12.2022, gjegjësisht pika I nënpika 5; pika II nënpika 1, 2, 3; pika III nënpika 26, pika IV nënpika 6, 8 dhe 9 të këtij raporti dhe rrjedhimisht aktet administrative që derivojnë nga i njëjti janë në kundërshtim me dispozitat e nenit 54 paragrafi 3 dhe 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyratet Publikë, si dhe dispozitat e nenit 48 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, të njëjtat vlerësohen si të paligjshme.

Këshilli, për sa me sipër dhe me qëllim të kthimit të ligjshmërisë në shërbimin civil, rekomandon organet gjegjëse, si në vijim:

Rekomandimi 1: Njësia Përgjegjëse – Departamenti për Menaxhimin e Zyratave Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme, rekomandohet që fillimisht të rregulloj statusin e pozitës së zëvendës drejtorëve të përgjithshëm:

duke aplikuar kështu përshtatshmërisht dispozitat e nenit 83 ndërlidhur me nenin 42 paragrafi 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyratet Publikë.

Rekomandimi 2: Komisioni i Ristrukturimit bazuar në autorizimet e dhëna sipas nenit 54 paragrafi 3 dhe 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyratet Publikë, rekomandohet që në pajtim me pikëpamjet juridike të dhëna në këtë raport, në ri procedurë të përgatis raport të ri lidhur me sistemimin e nëpunësve civil të cekur si në piken I nënpika 5; piken II nënpika 1, 2, 3; piken III nënpika 26; piken IV nënpika 6, 8 dhe 9 të Raportit me numër reference KR/ATK-08/2022 të datës 05.12.2022, duke dhënë shpjegim të situatës faktike

dhe shkaqeve të cilat kanë qenë vendimtare gjatë procesit të vlerësimit sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe të ndërmerr të gjitha veprimet tjera të nevojshme siç parashihet me dispozitat përkatëse të Ligjit për Zyrtarët Publikë.

Sistemimi i nëpunësve civil në pozita profesionale

Këshilli, nga analizimi i provave të administruara, po ashtu, ka gjetur se me hyrjen në fuqi të Rregullores Nr.02/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Tatimore të Kosovës, është shuar pozita e punës e *Udhëheqësit të Ekipit*, ndërsa detyrat dhe përgjegjësit e kësaj pozitë janë bartur në strukturat tjera themelore të krijuara si divizione në kuadër të strukturës së re organizative të ATK-së.

Rrjedhimisht, nga analizimi i Raportit me numër Reference KR/ATK 09/2022 të datës 07.12.2022, rezulton se nëpunësit civil të cilët kanë qenë duke ushtruar pozitën e *Udhëheqësit të Ekipit* janë propozuar nga komisioni përkatës i ristrukturimit për transferim në pozitë profesional, gjegjësisht pozitë të Zyrtarit të Lartë, me arsyetimin se pozita të cilën të njëjtit kanë qenë duke e mbajtur (*udhëheqës i ekipit*) nuk ka qenë e përcaktuar si pozite e kategorisë drejtuese me Ligjin Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.

Propozimi i komisioni të ristrukturimit ka pasur me lëshimin e vendimeve të transferimit dhe akteve të emërimit për nëpunësit civil në fjalë, ndërsa sipas të dhënave të regjistruara në data bazë, nëntëmbëdhjetë (19) prej tyre e kanë kontestuar vendimin për transferim nga pozita e udhëheqësit të ekipit në pozitën e zyrtarit të lartë, kategoria profesionale-1, përmes parashtrimit të ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Po ashtu, nga shkresat e administruara të lëndës rezulton se pas sistemimit, organi përkatës i punësimit të gjithë nëpunësit civil të cilët ushtronin pozitën e udhëheqësit të ekipit i ka emëruar si zëvendësues të përkohshëm në pozita të udhëheqësit të divizionit, në divizionet e krijuara me Rregulloren Nr.02/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Tatimore të Kosovës.

Këshilli në ndërlidhje me këtë çështje ka analizuar rregulloren për organizimin e brendshëm të vitit 2016 dhe atë të vitit 2019 të institucionit përkatës, dhe si rrjedhojë ka gjetur se Drejtoritë Rajonale udhëhiqeshin nga Drejtoret Operativ Rajonal të cilët për punën e tyre i raportonin drejtpërdrejt Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm për Operacione, ndërsa në kuadër të Drejtorive Rajonale, si njësi, funksiononin: Ekipi i Mbështetjes Administrative, Ekipet e Kontrollit, Ekipi i Shërbimit të Tatimpaguesve, Ekipi i Mbledhjes së Detyrueshme, Ekipi ZGJONA.

Rrjedhimisht, nga analizimi i përshkrimit të detyrave të punës të udhëheqësit të ekipit është konstatuar se qëllimi i kësaj pozitë ishte menaxhimi i punës së stafit të ekipit me

qellim të realizimit të planit vjetor të punës. Pra sipas përshkrimit të detyrave të punës udhëheqësi i ekipit ka ushtruar detyra drejtuese dhe për pasojë gjatë ushtrimit të detyrave të punës ka pasur nën menaxhim dhe ka udhëhequr një numër të caktuar të inspektorëve apo edhe zyrtarëve të tjerë që kanë qenë vartës të tyre.

Për me tepër, pozita e udhëheqësit të ekipit nga organi përkatës i punësimit në kontinuitet është rekrutuar sipas një procedure të rregullt rekrutuese dhe pas aprovimit paraprak nga ministria përgjegjëse për administratë publike, dhe si e tillë nuk ishte një pozitë e karakterit fiktiv e as e përkohshëm në Administratën Tatimore të Kosovës.

Këshilli në rastin në fjalë, ka vrejtur se komisioni përkatës i ristrukturimit nuk ka ndjekur standardin e njëjtë të krijuar nga vetë ky organ me rastin e propozimit për transferim të nëpunësve civil të tjerë, sepse nga analizimi raportit të komisionit është gjetur se i njëjti komision ka propozuar transferimin e Menaxherit të lartë për Operacione dhe Menaxherit të Zyrës Ekzekutive, në pozita të mesme drejtuese, ndonëse situata faktike ishte njëjtë apo e ngjashme, për faktin se edhe pozita e Menaxherit të lartë për Operacione si dhe ajo e Menaxherit të Zyrës Ekzekutive, nuk ishin pozita të përcaktuara si pozita të kategorisë se mesme drejtuese me Ligjin Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.

Andaj, duke qenë se organi përkatës i punësimit me rastin e ristrukturimit ka shuar ekipet, si njësi, me të cilat ka realizuar detyra dhe përgjegjësi në fusha të caktuara, për vite të tera, dhe si rrjedhojë në vend të tyre ka krijuar struktura të natyrës së divizioneve, dhe meqenëse divizionet konsiderohen si struktura themelore të organizimit të një organi të administratës shtetërore, komisioni i ristrukturimit në rrethanat e rastit konkret, duke marr parasysh edhe specifikat e institucionit, dhe standardin e vendosur paraprakisht për pozitat tjera të natyrës së njëjtë, është dashur të vlerësoj rast pas rasti nëse udhëheqësit e ekipit i plotësoj kriteret e punës për të qenë udhëheqës të divizioneve dhe t'i propozoj të njëjtit për emërim në pozita përkatëse.

Një situatë e tillë nuk do të ishte e pranueshme sikurse pozita e udhëheqësit të ekipit të parashihej në mënyrë taksative në ndonjë ligj apo akt nënligjor si pozitë e kategorisë profesionale, ngase në rrethanat e tilla nuk do të lejohej kalimi nga një kategori me e ulët në një kategori me të lartë funksionale, mirëpo ashtu sikurse është theksuar edhe nga vetë komisioni i ristrukturimit, kjo pozitë e punës është mjaft specifike dhe se për shkak të këtyre specifikave, përfshi këtu përshkrimin e detyrave të punës i cili në vetvete, në përqindje, përmban me tepër detyra të një pozicioni drejtues se sa të një pozite pune të kategorisë profesionale, dhe meqenëse divizioni sipas Ligjin për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, është strukturë themeltare e nivelit hierarkik më të ulët në kuadër të pozitave drejtuese, në administratën shtetërore, Këshilli vlerëson se komisioni përkatës i ristrukturimit duke propozuar që udhëheqësit e ekipeve të transferohen në pozita të kategorisë profesionale, pa një arsyetim të detajuar dhe bindes e i cili do të ndryshonte situatën e vlerësuar si me lartë, ka dështuar të vërtetoj në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike dhe si

rrjedhje gabimisht ka zbatuar ligjin material, për palët në procedurë, në këtë rast nëpunësit e prekur nga ky riorganizim.

Bazuar në rrethanat si me lartë, Këshilli konstaton se Raporti me numër reference KR/ATK-09/2022 i datës 07.12.2022, gjegjësisht pika II nënpikat me numër rendor 1, 2, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 14,15, 17 dhe 18 të këtij raporti dhe rrjedhimisht aktet administrative që derivojnë nga i njëjti janë në kundërshtim me dispozitat e nenit 54 paragrafi 3 dhe 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë, si dhe dispozitat e nenit 48 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, të njëjtat vlerësohen si të paligjshme.

Rekomandimi 3: Komisioni i Ristrukturimit bazuar në autorizimet e dhëna sipas nenit 54 paragrafi 3 dhe 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, rekomandohet që në ri procedurë të përgatis raport të ri lidhur me sistemimin e nëpunësve civil të cekur si në pikën II nënpikat me numër rendor 1, 2, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 14, 15, 17 dhe 18, të Raportit me numër reference KR/ATK-09/2022 të datës 07.12.2022, në pajtim me pikëpamjet juridike të dhëna në këtë raport, duke dhënë shpjegim të situatës faktike dhe shkaqeve të cilat kanë qenë vendimtare gjatë procesit të vlerësimit sikurse përcaktohet me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe të ndërmerret të gjitha veprimet tjera të nevojshme siç parashihet me dispozitat përkatëse të Ligjit për Zyrtaret Publikë.

Inspektoret Tatimor

Duke ju referuar Raportit me numër KR/ATK-09/2022 të datës 07.12.2022, Këshilli ka gjetur se, nga numri i përgjithshëm i nëpunësve civil të cilët ushtronin pozitën e Inspektorit Tatimor, komisioni i ristrukturimit disa prej tyre i ka propozuar për transferim në pozitën e Inspektorit të Lartë Tatimor-Kategoria profesionale 1, ndërsa disa të tjerë në pozitën e Inspektorit të Mesëm Tatimor-Kategoria profesionale - 2.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se njëqindnjëmbëdhjetë (111) nëpunës civil të cilët e mbanin pozitën e Inspektorit Tatimor janë propozuar nga komisioni përkatës i ristrukturimit për transferim në pozitën e Inspektor të Mesëm Tatimor - Kategoria profesionale 2.

Sipas propozimit të komisioni të ristrukturimit, secilit nëpunës civil veç e veç, i është lëshuar vendimi për transferim dhe akti i emërimit për pozitën e Inspektorit të Mesëm Tatimor, mirëpo të njëjtat vendime janë kontestuar nga nëpunësit civil të prekur nga riorganizimi, përmes parashtrimit të ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli, në lidhje me çështjen e sistemimit të nëpunësve civil në pozitën e punës të Inspektorit të Mesëm Tatimor ka analizuar Rregulloren Nr.02/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Tatimore të


Kosovës, gjegjësisht Shtojcën Nr.1 të kësaj rregulloreje, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtës ka gjetur se në departamentet përkatëse tatimore rajonale dhe divizionet në kuadër të këtyre njësive organizative, ku edhe janë propozuar dhe rrjedhimisht transferuar njëqindnjëmbëdhjetë (111) nëpunës civil, nuk ka numër të lejuar të stafit të kategorisë profesional 2, ngase sipas rregullores për organizimin e brendshëm në departamentet përkatëse operative është i lejuar vetëm pozicioni i punës i kategorisë profesionale 1, nga rrjedh se komisioni përkatëse i ristrukturimit, ka dështuar të vërtetoj drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe gabimisht ka zbatuar ligjin material me rastin e propozimit për transferim të nëpunësve civil nga pozita e Inspektorit Tatimor, në pozitë e Inspektorit të Mesëm Tatimor-Kategoria profesionale 2, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Tatimore të Kosovës.

Bazuar në rrethanat si me lartë, Këshilli konstaton se Raporti me numër reference KR/ATK-09/2022 i datës 07.12.2022, gjegjësisht pika I nënpikat me numër rendor nga 252-255, 257, 261-264, 266-269, 275-278, 280-285, 289-290, 292, 299, 301-304, 306, 309, 311-315, 317, 320-322, 326, 329-331, 333-336, 338, 340-342, 347-354, 356, 358-359, 361, 363, 368-369, 372-374, 376, 381, 383, 385-386, 390-391, 395-396, 401-404, 406, 408-409, 412-123, 415, 419-421, 427, 429, 431-432, 434-438, 441, 444, 448, 454, 456, 459-460, dhe 463, të këtij raporti dhe rrjedhimisht aktet administrative që derivojnë nga i njëjti janë në kundërshtim me dispozitat e nenit 54 paragrafi 3 dhe 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë, Rregulloren Nr.02/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Tatimore të Kosovës, si dhe dispozitat e nenit 48 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, të njëjtat vlerësohen si të paligjshme.

Rekomandimi 4: Komisioni i Ristrukturimit bazuar në autorizimet e dhëna sipas nenit 54 paragrafi 3 dhe 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, rekomandohet që në ri procedurë të përgatis raport të ri lidhur me sistemin e nëpunësve civil të cekur si në piken I nënpika me numër rendor nga 252-255, 257, 261-264, 266-269, 275-278, 280-285, 289-290, 292, 299, 301-304, 306, 309, 311-315, 317, 320-322, 326, 329-331, 333-336, 338, 340-342, 347-354, 356, 358-359, 361, 363, 368-369, 372-374, 376, 381, 383, 385-386, 390-391, 395-396, 401-404, 406, 408-409, 412-123, 415, 419-421, 427, 429, 431-432, 434-438, 441, 444, 448, 454, 456, 459-460, dhe 463, 473, 477, 480, 483, 485-487, 541, 546, në pajtim me pikëpamjet juridike të dhëna në këtë raport, duke dhënë shpjegim të situatës faktike dhe shkaqeve të cilat kanë qenë vendimtare gjatë procesit të vlerësimit sikurse përcaktohet me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe të ndërmerret të gjitha veprimet tjera të nevojshme siç parashihet me dispozitat përkatëse të Ligjit për Zyrtaret Publikë.


Këshilli, nga analizimi i raporteve të komisionit të ristrukturimit, përveç të gjeturave si me lartë, nuk ka vërejtur shkelje të tjera në këtë proces të ristrukturimit e që ndërlidhen me ankesat e parashtruara në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Mirëpo, edhe përkundër kësaj, organet gjegjëse, në ri procedurë, obligohen që *ex offico* të kujdesen që të këtë trajtim të barabartë të nëpunësve civil për aq sa rrethanat apo natyra e çështjes është e njëjtë apo e ngjashme dhe të ndërmarrin veprime tjera të nevojshme në pajtueshmëri me legjislacionin e aplikueshëm për Zyrtarët Publikë.

Avdyl BEKTESHI



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Jeton KOÇA



Kryetar i Kolegjit